



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 514/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie Morina Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 25.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Anr.514/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 2704B/02R, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

II. REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.514/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në pjesën që ka kërkuar ankuesi që në Vendvotimin 2705B/01D, të shpallet 1 (një) fletëvotim i pavlefshëm.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 24.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.514/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më 24.11.2019 rreth orës 08:00 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 2704B/02R dhe në kutinë 2705B/01D janë shpallur dy fletëvotime të vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullores Zgjedhore 06/2013, ku në kutinë 2704B/02R, në të cilën gjendët fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja “TIK”, në katrorin e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, mirëpo, jashtë katrorit të nr. 131 të subjektit politik IRDK, konkretisht ngjitur me llogon e këtij subjekti është shënuar me laps-kimik një shenjë “vizë”, e cila e bënë të pavlefshme këtë fletëvotim, gjithashtu, në kutinë e votimit, 2705B/01D në të cilën gjendët fletëvotimi i kontestuar është shënuar shenja “TIK”, në katrorin e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, mirëpo, brenda katrorit të subjektit politik LDK, brenda katrorit është shënuar një “vizë” e cila e bënë të pavlefshëm këtë fletëvotim, më tutje thekson se nga shikimi i këtyre fletëvotimeve vërehet qartë se votuesi ka shkrehur vullnetin politik ose ti votoj dy subjektet politike ose ka

shprehur vullnetin që mbi ato fletëvotime përmes atyre shenjave ta bëjë qëllimin e votuesit të paqartë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provës së bashkangjitur në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Ankuesi ka paraqitur pretendimin se në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ku ka kërkuar nga PZAP-i, që dy fletëvotime në kutitë e votimit 2704B/02R dhe 2705B/01D të shpallen të pavlefshme sepse bien në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013.

Paneli në bazë të konstatimit zyrtar nga ekipi hetimor i PZAP-së, vërteton se qëndron pretendimi i ankuesit sa i përket pjesës se në Vendvotimin 2704B/02R është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që në fletëvotimin e kontestuar është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “NISMA”, ndërsa jashtë katrorit të subjektit politik IRDK me numër 131, konkretisht ngjitur me llogon e këtij subjekti është shënuar me laps kimik një shenjë (vizë), e cila e bënë të pavlefshëm këtë fletëvotim për arsye se nuk dihet qëllimi i qartë i votuesit dhe si të tillë këtë pretendim Paneli e pranoj të bazuar sikur në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës se në Vendvotimin 2705B/01D është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që në fletëvotimin e kontestuar brenda katrorit të subjektit politik “NISMA” është shënuar shenja “tik”, kurse brenda katrorit të subjektit politik LDK me numër 134 është shënuar një vizë, në bazë të konstatimit zyrtar nga ekipi hetimor i PZAP-së, është konstatuar se fletëvotimi në fjalë nuk përmbushë asnjë kriter të pavlefshmërisë pasi që dihet qëllimi i qartë i votuesit, andaj Paneli vendosi si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, “*PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga pavlefshmëria e fletëvotimit të vendosur si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni të bashkangjitur në këtë vendim, duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.


Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 514/2019 më datën 25.11.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltëne Syleimani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



2019











PARLAMENTI IZBORI ZA SAOPSTAVNO REPUBLIKU KOSOVO 2019
2019 KOSOVA CUMHURİYETİ MECLİSİ ERKEN SEÇİMLERİ

1. Shtetori VETËMI NJË subjekt politik
Oznanja SAMO JEDAN politicki subjekt
SADECE BIR s'yaş kunduzi i qeveri eyn

2. Shtetori MË BË BIRUJTI PËRË shtet
Oznanja NAJYNË PËT tandoja
BIR PAZLA BËS shtet qatetorm

<input type="checkbox"/>	111.	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE	1	2	3	4
<input type="checkbox"/>	112.	AK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	5	6	7	8
<input type="checkbox"/>	113.	PAJ PARTIA E ASHKALINJEVER PER NTEGORIN - PAI	9	10	11	12
<input type="checkbox"/>	114.	STRANKA DEMOKRATISKE AKCIE - SDA	13	14	15	16
<input type="checkbox"/>	115.	PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS	17	18	19	20
<input type="checkbox"/>	116.	PAJ PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALINJE TE KOSOVËS - PDAK	21	22	23	24
<input type="checkbox"/>	117.	POKRET ZA GORA - PG	25	26	27	28
<input type="checkbox"/>	118.	NOVA DEMOKRATISKA STRANKA - NDS	29	30	31	32
<input type="checkbox"/>	119.	AAK - PËT PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË	33	34	35	36
<input type="checkbox"/>	120.	SLOBODA	37	38	39	40
<input type="checkbox"/>	121.	SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS	41	42	43	44
<input checked="" type="checkbox"/>	122.	NISMA SOCIALDEMOKRATË A ALENCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISE	45	46	47	48
<input type="checkbox"/>	123.	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP	49	50	51	52
<input type="checkbox"/>	124.	V KOALICIJA VAKAV	53	54	55	56
<input type="checkbox"/>	125.	FJALLA	57	58	59	60
<input type="checkbox"/>	126.	LËVIZJA VETËVENDOSJEI	61	62	63	64
<input type="checkbox"/>	127.	KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KÖTP	65	66	67	68
<input type="checkbox"/>	128.	PARTIA ROMË E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK	69	70	71	72
<input type="checkbox"/>	129.	PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK	73	74	75	76
<input type="checkbox"/>	130.	KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP	77	78	79	80
<input type="checkbox"/>	131.	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	81	82	83	84
<input type="checkbox"/>	132.	ESMIR KASI	85	86	87	88
<input type="checkbox"/>	133.	GRADANSKA INICIATIVA GORE - GIG	89	90	91	92
<input type="checkbox"/>	134.	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	93	94	95	96
<input type="checkbox"/>	135.	SERPISKA LISTA	97	98	99	100
			101	102	103	104
			105	106	107	108
			109	110		

2704B/02R

- 125.  FJALA
- 126.  LËVIZJA VETËVENDOSJEI
- 127.  KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI - KDTP
- 128.  PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- 129.  PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- 130.  KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- 131.  INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- 132. ESMIR KASI
- 133.  GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG
- 134.  LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- 135.  SRPСКА LISTA